

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.Z. nga fsh., K. Kamenicës, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag.1 nën parag. 1 i KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani PP.nr.165/2007 të dt.25.04.2007, në shqyrtimin e hapur gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shefik Mehmeti, të akuzuarit F.Z., më dt.29.10.2014 komunikoi, ndërsa më dt.07.11.2014 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i ,

F..Z., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, i lindur më „data e lindjes,, ..., në f.sh., K. e Kamenicës, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Se më datë 11.01.2007, në orët e hershme të mëngjesit, në fsh., me qëllim që veti ti sjellë një përfitim të kundërligjshëm pasuror, me marrjen e sendeve të huaja te luajtshme ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarve: E. dhe H.G. nga, në atë mënyrë që fillimisht me forcë thyen dritaren e shtëpisë së të dëmtuarve dhe pasi ka hyrë brenda ka marr, gjithë instalimin e rrymës elektrike, ka dëmtuar matësin e rrymës elektrike (orën) ka marr mbulojën e shkallëve , një kabllo përçuese të antenës televizive, ndërkaq në oborrin e shtëpisë ka marr katër tela të rrymës elektrike dhe atë prej shtyllës elektrike gjer në shtëpi dhe me këtë të dëmtuarve u ka shkaktuar dëm material në vlerën e pa përcaktuar.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag. 1 nën parag.1 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4,41,50,51,52,73,75 dhe nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton

Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarit, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse i akuzuari brenda afatit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

I dëmtuari E.G. nga ... për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I dëmtuari H.G. nga ... nuk parashtrori kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.165/2007 të dt.25.04.2007, ka akuzuar F.Z. nga f.sh...., K. e Kamenicës, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag.1 nën parag.1 të KPK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I dëmtuari E.G. në fjalën e tij përfundimtare i'u ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe parashtrori kërkesë pasurore juridike, ndërsa i dëmtuari H.G. në fjalën e tij përfundimtare nuk i'u ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari F.Z. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se është vjedhur shtëpia e të dëmtuarve E.e H.G., mirëpo konteston faktin se ai të ketë kryer këtë vepër penale, po ashtu nuk mohon faktin se policët gjatë hetimeve e kanë takuar djalin e tij te furgoni i cili ka mbledhur hedhurina të metalta mirëpo mohon që fëmiju i tij ti ketë ndihmuar personit i cili ka mbledhur hedhurina, në mënyrë kategorike mohon që në oborrin e shtëpisë së tij të jenë gjetur sendet e vjedhura nga shtëpia e të dëmtuarve , as mjetet për ngjitjen në shtylla elektrike nuk janë gjetur tek ai dhe për të njëjtat nuk ka njohuri dhe nuk e di se çka janë, për këtë vjedhje ka kuptuar pasi duke kaluar me bagëti rreth shtëpisë e cila nuk ka pasur rrethojë dhe ka parë se dera është e hapur.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari nuk e ndien veten fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe kërkon nga gjykata pasi nuk është kryerës i veprës penale për të cilën ngarkohet që ta liroj nga përgjegjësia penale.

Gjykata në procedurën provuese ka bërë shikimin dhe leximin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: raporti i hetimeve me nr. 2007-CB-0027, raporti shtesë i hetimeve me numër të njëjtë të rastit të dt.13.02.2007, ka shikuar foto dokumentacionin, ka dëgjuar të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarëve dhe dëshmitarin.

Në procedurën provuese gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit të dëmtuarin H.G. i cili ka dëshmuar se, në vitin 2007 ju është vjedhur shtëpia ka lajmëruar rastin në polici pasi kohën e fundit nuk ka banuar në shtëpi nuk ka njohuri se dyert e shtëpisë a kanë qenë të mbyllura , dritaret kanë qenë të thyera , ka munguar instalimi i rrymës

në shtëpi, mbuloja e shkallëve nga llamarina, ndërsa për njehsorin elektrik nuk i kujtohet, para vitit 2007 ka banuar vëllau E.G., ndërsa për sendet e vjedhura nuk ka njohuri a janë gjetur dhe a janë konfiskuar nga ana e policisë.

Në procedurën provuese gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit edhe të dëmtuarin E.G. i cili ka dëshmuar se, shtëpia e cila është vjedhur ka qenë shtëpi e përbashkët me vëllaun H.G. ndërsa nga viti 2004 nuk jeton askush në këtë shtëpi, vëllau pasi ka parë se muret e shtëpisë në fshat janë dëmtuar, dritaret janë thyer, njehsori elektrik i thyer dhe i gjuajtur në dysheme, po ashtu në oborrin e shtëpisë kanë munguar tri karaseri të metalta të motoçikletave, kryesisht janë marrë sendet e metalta, rastin e ka lajmëruar në polici, hetuesit policor janë marr me rastin, sendet e grumbulluara për tu shitur për hedhurina i ka identifikuar se janë të shtëpisë së tij të cilat janë gjetur në afërsi të shtëpisë të të akuzuarit rrugë të cilën e shfrytëzon vetëm ai, ndërsa një kareseri e motoçikletës e metal, kabllo elektrike, antena e TV, një dorëz e derës, kabllo nga shtylla elektrike deri tek konzolla e shtëpisë të cilat poashtu i ka identifikuar janë gjetur në oborrin e shtëpisë të të akuzuarit, pasi sendet kanë qenë të dëmtuara jo funksionale nuk i ka marr asnjërën prej tyre.

Në procedurën provuese gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarin S.K. i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se: gjatë hetimeve kanë dalur në vend të ngjarjes, kanë takuar një person i cili merret me grumbullimin e hedhurinave të metalta duke ngarkuar sendet e metalta, në mesin e tyre ka qenë një ram i metaltë i motoçikletave të modelit “Java”, një dorëz e derës së metalt, kabllo e antenës të cilat i ka identifikuar i dëmtuari E.G. se janë sende nga shtëpia e tij, te furgoni ka qenë djali i tani të akuzuarit i moshës përafërsisht 8 vjet i cili ka qenë brenda në furgon duke ndihmuar personit për t’i ngarkuar gjërat, gjërat kanë qenë të grumbulluara edhe në shtëpinë e të akuzuarit, kabllo elektrike kanë qenë të hequra nga shtylla elektrike deri në shtëpinë e të dëmtuarve, koha ka qenë me shi dhe gjatë përcjelljes së gjurmëve të njëjtat kanë shkuar deri te shtëpia e të akuzuarit.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, në përputhje me nenin 361 të KPPRK-së, për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e akuzës ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se është thyer-vjedhur shtëpia e të dëmtuarve H. e E.G. në fshatin ... (e cila gjë është pohuar edhe nga vet i akuzuari), gjithashtu se sendet e vjedhura janë gjetur në shtëpinë e të akuzuarit dhe duke u shitur te personi që mbledh hedhurina të metalta nga djali i të akuzuarit, ku të gjitha këto sende janë identifikuar nga i dëmtuari E.G.

Gjykata në tërësi i ka kushtuar besim dëshmisë së të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve H.E. si dhe dëshmitarit hetuesit policor S.K. ngase dëshmitë e tyre kanë qenë bindëse, në përputhje njëra me tjetrën si dhe me provat tjera materiale, me foto-dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës, ku shihet kjo dëmtimi i shtëpisë, furgoni me sendet e ngarkuara dhe të identifikuara nga i dëmtuari E.G. ashtu siç cekën në aktakuzë.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit mirëpo mbrojtjes së tij gjykata nuk ia fali besimin pasi e konsideron të pa bazuar dhe këtë e ka bërë me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale për veprën për të cilën akuzohet .

Nga provat që u elaboruan më lartë, qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag. 1 nën parag.1 të KPK-së.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori: sjelljen korrekte në gjykatore, mbajtës i familjes, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale , koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese ndaj ti nuk gjeti. Për këtë arsye kjo Gjykatë vlerëson se në rrethana të tilla edhe vetëm kërcënimi me dënim, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin prevencionit individual dhe gjeneral.

I dëmtuari E.G. nga ..., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

I dëmtuari H.G. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike,

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë në pajtim të nenit 365 të KPRK-së , ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 07.11.2014, P.125/2007

Procesmbajtësja,

Emine Zubaku,d,v

Gj y q t a r j a ,

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej
15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

